



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 138/4 Prot.

Tiranë, më 20.05.2021

V E N D I M

Nr.54, datë 20.05.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë të mosveprimit të njësisë përgjegjëse për emërimin nga lista e fituesve të konkurrenive me kod # 2054 dhe # 2111, të konkurrentit ***.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; nenit 90/1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së procedurës së konkurrimit me kod # **2054** dhe # **2111**, për pozicione të lira në institucionin Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.

Vërej se:

Shtetasi ***** , nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 138 prot., datë 10.02.2021 “Ankesë”, ka ngritur disa pretendime për parregullsi dhe shkelje të lejuara nga ana e njësisë përgjegjëse, në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, në lidhje me mosveprimin brenda afatit ligjor, për emërimin nga lista e fituesve, në dy procedurat e konkurrimit me kod #**2054** dhe #**2111**, për pozicionet e lira të shpallura ndërkohë, në institucionin Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.

Për efekt të kryerjes së hetimit administrativ, si dhe për të qartësuar pretendimet mbi problematikën e paraqitur, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 138/1 prot., datë 09.03.2021, “Kërkim dokumentacioni për verifikimin e pretendimeve të konkurrentit ***** , në

lidhje me zhvillimin e procedurave të pranimit në shërbimin civil, me kod #2054 dhe #2111”, drejtuar Departamentit të Administratës Publike, ka njoftuar fillimin e verifikimit të ligjshmërisë së këtij rasti, duke kërkuar edhe dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e këtij hetimi administrativ. Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 1767/1 prot., datë 26.03.2021, “*Kthim përgjigje*”, ka vënë në dispozicion gjithë praktikën e kërkuar në lidhje me veprimet administrative të kryera.

Nga përmbajtja e akteve të vëna në dispozicion, rezulton e vërtetuar se konkurenti ***** , ka qenë pjesëmarrës dhe fitues, në dy procedura konkurrimi, përkatësisht në shpalljet:

- *Kodi #2054* – Inspektor në Sektorin e Kontrollit të Skemave Kombëtare, në Drejtorinë e Kontrollit në AZHBR; Lloji i diplomës “*Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike/Shkenca Bujqësore/ Shkenca Inxhinierike/ Shkenca Natyrore*” (në këtë procedurë kandidati ***** është renditur i tretji në listë, me 73.2 pikë);
- *Kodi #2111* – Inspektor në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve Kombëtare, në Drejtorinë e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve në AZHBR; Lloji i diplomës “*Shkenca Bujqësore/ Shkenca ekonomike/ Shkenca Juridike/Inxhinieri Mjedisi/Inxhinieri Mekanike/Inxhinieri Ndërtimi*” (Në këtë procedurë kandidati ***** është renditur i katërti në listë, me 77.4 pikë);

Duke qenë se pozicionet që ishin shpallur për konkurrim, u plotësuan nga konkurrentët fitues me pikë më të larta, konkurenti ***** , në datën 23.01.2019, ka nënshkruar deklaratën përkatëse, për tu regjistruar në listën e kandidatëve fitues të paemëruar ende, e cila në bazë të pikës 3, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, mbahet nga njësia përgjegjëse dhe është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare nga momenti i shpalljes së fituesve.

Në lidhje me sa më sipër, si dhe nga përgjigja e DAP (në rolin e njësisë përgjegjëse) rezulton se vlefshmëria e qëndrimit të konkurrentit ***** , në listat fituese të procedurave të pranimit në shërbimin civil (për kodet e shpalljeve #2054 dhe #2111), me plotësimin e afatit dy vjeçar, ka përfunduar gjë e cila shënon dhe shuarjen e të drejtës së tij, për të kërkuar emërimin nga lista e fituesve të paemëruar ende.

Pretendimi i ngritur prej tij, se gjatë kohës së vlefshmërisë së listës, nuk është thirrur në asnjë rast për t’u emëruar në ndonjë pozicion të shërbimit civil, qoftë edhe për një periudhë të përkohshme, nuk mund të merret në konsideratë, pasi Departamenti i Administratës Publike, si njësia që administron listën e mësipërme, ka të drejtën të përzgjedhë nga grupi i

administrimit të përgjithshëm/të posaçëm, një nga kandidatët fitues që ka mbetur në listë, sipas renditjes me pikë, që i përshtatet më mirë kërkesave të vendit të punës.

Nisur nga përmbajtja e dy listave, ku kandidati ***** ka qenë regjistruar si fitues, rezulton se nuk ka patur asnjë emërim përfundimtar prej tyre, ndërsa me kërkesë të institucionit AZHBR, janë emëruar në mënyrë të përkohëshme nga kjo listë, konkurrentët ***** dhe ***** , kandidatë të renditur më lart në listën fituese, përkatësisht me 86.8 pikë dhe 82.4 pikë.

Prej fakteve të mësipërme, arrihet në përfundimin se pretendimi që ngre ankuesi ***** , se ka patur emërim nga listat fituese me kod #2054 dhe #2111, për kandidatë që kanë patur pikë më pak se ai, nuk qëndron.

Në lidhje me pretendimin tjetër të kërkuesit, se janë bërë rishpallje të pozicioneve të mësipërme të punës, ndërkohë që ka patur kandidatë fitues në listë, sqarojmë se bazuar në vendimin nr. 108, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”*, të ndryshuar, çdo institucion i administratës shtetërore, në fillim të vitit në vazhdim, përgatit planin e nevojave për rekrutim në shërbimin civil, mbi bazën e të cilit më pas Departamenti i Administratës Publike, harton planifikimin vjetor të pranimit për grupe pozicionesh. Në ato raste kur shpallen pozicione pune, për të cilat ka konkurrentë fitues në listë, bazuar në nenin 23, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, nëse gjatë afatit dy vjeçar të vlefshmërisë së listës fituese zhvillohet një procedurë tjetër konkurrimi për të njëjtën grup, kandidatët fitues që nuk janë emëruar ende, rirenditen sipas rezultatit përfundimtar.

Rirenditja e kandidatëve bëhet për grupe të njëjta të administrimit të përgjithshëm ose të posaçëm, që nënkupton grupet e pozicioneve të cilat kanë të njëjtat kritere të posaçme, të njëjtin përshkrim pune e ku kërkohet e njëjta fushë njohurish.

Gjatë periudhës së vlefshmërisë së listave fituese, rezulton se ankuesi ***** , është rirenditur në listat e procedurës me kod # 2111 dhe me kod # 2901, gjë e cila ka ndikuar në faktin që kandidatët me rezultate më të larta, ta ardhur nga konkurrimet e reja, janë preferuar në ato raste që janë paraqitur për emërim të reja.

Nga sa u parashtrua më sipër dhe nga analiza në tërësi e dokumentacionit të administruar arrihet në përfundimin se, veprimet e njësisë përgjegjëse janë kryer në përputhje me kërkesat e parashikuara në pikën 3, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar dhe vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”* të ndryshuar, prandaj hetimi administrativ nuk është e nevojshme të vazhdojë më tej dhe çështja të arkivohet.

Për këto arsye:

Në zbatim të nenit 15 pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, neneve 54 e 55, pikave “d” dhe “dh” të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH” dhe neneve 16, pika 6 dhe 34, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë:

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të kërkesës me nr. 138 prot., datë 10.02.2021, të dërguar nga nëpunësi *****, me objekt verifikimin e pretendimeve për parregullsi të kryera apo të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, në lidhje me mos emërimin e tij nga lista e pritjes së fituesve, në dy procedurat me kod #2054 dhe #2111 (*procedura konkurrimi të zhvilluara në prill të vitit 2019*), për pozicionet e lira në institucionin Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural dhe arkivimin e saj.
2. Të njoftohet për këtë vendim Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, njësia përgjegjëse (DAP) dhe kërkuesi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha